

Fjalat e Paqes

Jezusi u tha:
"Ejani pas peje e do t'ju bëj
peshkatarë njerëzish!".
Ata aty për aty i lanë rrjetat
e shkuan pas tij.
(Mk 1, 17-18)

Lajmëtar fetaro-kulturor i Arqipeshkvisë Metropolitane Shkodër - Pult Nr. 1 (120) Viti XVII Dhjetor 2014 - Janar 2015

PAPA FRANÇESKU NË MESAZHIN E PAQES

“Jo më skllëvër, por vëllezër!”

Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Paqes, si zakonisht Papa Françesku, dha botës mesazhin e tij. Edhe këtë vit si çdo vit, ky mesazh u përkthye, nën kujdesin e posaçëm të Imzot Angelo Massafrës për t'ua përcjellë besimtarëve. Ky aktivitet u parapri nga Marshimi i Paqes, i cili u realizua nga shoqata Sant'Egidio, në bashkëpunim me Arqipeshvinë dhe Komisionin “Drejtësi dhe Paqe” duke u nisur nga Katedralja. Tashmë është kthyer në një traditë të këndshme, filluar 15 vjet më parë, që mesazhin e Atit të Shenjtë ta servirin për popullin e Shkodrës përmes një programi artistik me këngë, valle dhe recitime në teatrin “Migjeni” të Shkodrës.

Në vazhdim të kësaj tradite, për zhvillimin e aktivitetit kulturor u zgjodh data 8 Janar. Nën prezantimin e çiftit Simon dhe Eliona Shkreli, zëri dhe fytyrat e të cilëve në mendjen e publikut të Shkodrës shoqërohen automatikisht me fjalën gazetar, të pranishmit shijuan një program artistik të larmishëm me pjesë të zgjedhura. Mesazhi i Shenjtërisë së Tij “Jo më skllëvër, por vëllezër!” tingëlloi më aktual se kurrë sivjet kur bota është përfshirë në një vorbull luftërash të egra, fryme terroriste dhe një krize ekonomike, fundi i së cilës duket i largët. Shkak për këtë gjendje është pikërisht mungesa e dashurisë dhe e solidaritetit mes njerëzve, që harrojnë se janë krijesa të Hyjit, në shëmbëlltëri të Tij, dhe vënë re te njëri-tjetri më shumë dallimet, sesa vlera të përbashkëta. Mesazhe paqeje dhe bashkimi, së bashku me Imzot Massafrën dha edhe Atë Nikolla Petani. Urojmë që fjalët e Imzot Angelo Massafrës dhe të Atë Nikolla Petanit të kenë zënë vend në zemrat dhe mendjet e të pranishmëve dhe që ata t'ua komunikojnë këtë frymë atyre që kanë përreth: shpresojmë që në këtë vit të kemi sa më pak



raste mosmarrëveshesh e konfliktesh dhe sa më shumë shembuj shpirtmirësie e dhembshurie për tjetrin siç urdhëron Hyji dhe siç na mëson Papa Françesku në mesazhin e tij.

Në vijim ja ndërhyrja e Imzot Angelo Massafrës:

“Shumë të Nderuara Autoritete fetare, shumë të Nderuara Autoritete Civile, shumë të dashur vëllezër e motra!

Vit të mbarë të gjithëve!

Sot do të doja t'ua dërgoj çdo burri e çdo gruaje të dioqezës sonë bekimin e Zotit dhe urimin tim të paqes për një Vit të mbarë për Shkodrën e për Veriun.

Falënderoj Z. Luigj Mila, Përgjegjës i Qendrës “Drejtësi e Paqe”, shkollat tona, grupet famullitare, bashkëpunëtorët dhe Drejtorin e Teatrit për këtë mbrëmje të bukur.

“Jo më skllëvër, por vëllezër!” kjo është tema e ditës XLVIII Botërore për Paqen. Falënderojmë Papa Françeskun për këtë mesazh. Mesazhi për Ditën Botërore të Paqes u dërgohet Kishave dhe Shteteve të mbarë botës për të kujtuar vlerën thelbësore të paqes dhe nevojën për të vepruar pa u lodhur për ta arritur atë.

Papa Françesku ka zgjedhur këtë temë në vazhdim të temës së vitit të kaluar: “Vëllazërimi, themel dhe udhë për paqen”. Qysh prej fillimit të shërbesës së tij si ipeshkëv i Romës, Papa ka theksuar rëndësinë e “kulturës së takimit- të solidaritetit”, për të ecur drejt realizimit të një bote më të mirë dhe paqësore.

“Shfrytëzimi i njeriut nga njeriu” përbën një “plagë” dhe një “dukuri të urryeshme”, që çojnë “në shkeljen e të drejtave themelore të tjetrit dhe në asgjësimin e lirisë dhe të dinjitetit”. Papa Françesku na fton që të fitojmë mbi indiferencën dhe të bëjmë “gjeste vëllazërie ndaj atyre

Vijon në fq.4



2-3 PAPA
FRANÇESKU
NË TURQI

KRISHTLINDJE NË MALE

5-12

PAPA FRANÇESKU NË TURQI

TAKIMI ME AUTORITETET

Papa Françesku me datat 28-30 nëntor 2014 bëri Udhëtimin Apostolik në Turqi duke takuar Autoritete Civile dhe Fetare. Në vijim po paraqesim fjalimin e Atit të shenjtë, drejtuar në Ankara Autoriteteve Shtetërore, më 28 nëntor:

Zoti President, të Nderuara Autoritete, Zonja dhe Zotërinj, jam i lumtur që po vizitoj Vendin tuaj, të pasur me bukuri natyrore dhe historike, të mbushur me gjurmë të hershme të qytetërimit dhe urë natyrore mes dy kontinenteve dhe mes shprehjeve të ndryshme kulturore. Kjo tokë është e dashur për çdo të krishterë, sepse është vendlindja e shën Palit, i cili këtu themeloi disa bashkësi të krishtera; sepse ka mikpritur shtatë Koncilet e para të Kishës dhe për praninë, afër Efezit, të asaj që një traditë e nderuar e konsideron “shtëpinë e Marisë”, vendin ku Nëna e Jezusit ka jetuar për disa vjet, cak devocioni për shumë shtegtarë nga çdo anë e botës, jo vetëm të krishterë, por edhe myslimanë.

Megjithatë, arsyet e konsideratës dhe të vlerësimit për Turqinë nuk duhet të kërkojnë vetëm në të kaluarën e saj, në monumentet e saj të hershme, por gjenden në gjallërinë e së tashmes së saj, në zellin dhe bujarinë e popullit të saj, në rolin e saj në koncertin e kombeve.

Është për mua arsye gëzimi të kem mundësinë të vazhdoj me ju një dialog miqësie, vlerësimi dhe respekti, në vazhden e atij të ndërmarrë prej paraardhësve të mi: të lumit Pali VI, shën Gjon Palit II dhe Benediktit XVI, dialog i përgatitur dhe i favorizuar prej veprimit të Delegatit të atëhershëm Apostolik Imzot Angelo Giuseppe Roncalli-t, pastaj prej shën Gjonit XXIII dhe prej Koncilit II të Vatikanit.

Nevojë për një dialog të thellë

Kemi nevojë për një dialog që thëllon njohjen dhe vlerëson me shoshitje gjërat e shumta që kemi të përbashkëta, e në të njëjtën kohë na mundëson t'i konsiderojmë me shpirt të urtë e të kthjellët ndryshimet, që të mundemi të nxjerrim mësim edhe prej tyre.

Duhet ta çojmë përpara me durim angazhimin për të ndërtuar një paqe të qëndrueshme, të bazuar në respektimin e të drejtave themelore dhe të detyrave të lidhura me dinjitetin e njeriut. Nëpër këtë rrugë mund të kapërcehen paragjykimet dhe frikat e rreme dhe u bëhet hapësirë vlerësimit, takimit dhe zhvillimit të energjive më të mira në dobi të të gjithëve.

Me këtë qëllim është themelore që shtetasit myslimanë, hebrenj dhe të krishterë – si në dispozitat e ligjit, ashtu edhe në aktualizimin e tyre efektiv –, të gëzojnë të njëjtat të drejta dhe të respektojnë të njëjtat detyra. Ata në këtë mënyrë do ta njohin më lehtë njëri-tjetrin si vëllezër dhe shokë rruge, duke larguar gjithnjë e më shumë moskuptimet dhe duke favorizuar bashkëpunimin e marrëveshjen. Liria fetare dhe liria e shprehjes, të garantuara në mënyrë efikase për të gjithë, do të nxisin lulëzimin e miqësisë, duke u bërë një shenjë shprehëse e paqes.

Lindja e Mesme, Europa dhe Bota e presin këtë lulëzim. Lindja e Mesme, në veçanti, prej shumë vitesh është teatër i luftërave vëllavrasëse, që duket se lindin nga njëra-tjetra, a thua se e vetmja përgjigje e mundshme ndaj luftës dhe ndaj dhunës është gjithmonë një luftë e re dhe një tjetër dhunë.

Për sa kohë duhet të vuajë ende Lindja e Mesme për shkak të mungesës së paqes? Nuk mund të dorëzohemi para vazhdimit të konflikteve, a thua se nuk është i mundur një ndryshim për mirë i

situatës! Me ndihmën e Zotit, mundemi dhe duhet gjithmonë ta përtërijmë guximin e paqes! Ky qëndrim na bën të përdorim me çiltërsi, durim dhe vendosmëri të gjitha mjetet e negociatave, si dhe të arrijmë kështu objektivat konkrete të paqes dhe të zhvillimit të mundshëm.

JO çdo formë e fundamentalizmit dhe e terrorizmit

Zoti President, për ta arritur këtë pikësynim të lartë dhe urgjent, një ndihmesë e rëndësishme mund të vijë prej dialogut ndërfetar dhe ndërkulturor, kështu që të zhduket çdo formë e fundamentalizmit dhe e terrorizmit, që e poshtëron rëndë dinjitetin e të gjithë njerëzve dhe e instrumentalizon besimin.

Fanatizmit dhe fundamentalizmit, fobive të paarsyeshme që nxisin moskuptime e diskriminime, duhet t'u kundërvihet solidariteti i të gjithë

besimtarëve, që ka si shtylla respektimin e jetës njerëzore dhe të lirisë fetare, që është liri e kultit dhe liri për të jetuar sipas etikës fetare, përpjekjen për t'u garantuar të gjithëve të nevojshmen për një jetë dinjitoze dhe një kujdes për mjedisin natyror. Për këtë kanë nevojë, me urgjencë të veçantë, popujt dhe Shtetet e Lindjes së Mesme, që më në fund “ta kthejnë orientimin dhe të çojnë përpara me rezultat pozitiv një proces paqësimi, nëpërmjet mohimit të luftës e të dhunës dhe kërimit të dialogut, të së drejtës dhe të drejtësisë.

Në të vërtetë, deri sot mjerisht jemi ende dëshmitarë të konflikteve të

rënda. Në Siri dhe në Irak, në mënyrë të veçantë, dhuna terroriste nuk tregon shenja se po zbutet. Vërehet dhunimi i ligjeve më elementare njerëzore ndaj robërve dhe ndaj grupeve të tëra etnike; janë vërejtur dhe ndodhin ende përndjekje të rënda në dëm të grupeve minoritare, veçanërisht – por jo vetëm –, të krishterë dhe jazidë: qindra mijëra persona janë të detyruar të lënë shtëpitë dhe atdheun e tyre që të mund të shpëtojnë jetën e tyre dhe t'i rrinë besnikë fesë së tyre.

Turqia, duke pranuar bujarisht një numër të madh të arratisurish, është e përfshirë drejtpërdrejt prej efekteve të kësaj situatë dramatike në kufijtë e saj dhe bashkësia ndërkombëtare ka detyrën morale ta ndihmojë që të kujdeset për të arratisurit. Së bashku me asistencën e nevojshme humanitare, nuk mund të rrihet mospërfillës përballë asaj që i ka shkaktuar këto tragjedi. Duke përsëritur se është e ligjshme të ndalet sulmi i padrejtë, por gjithmonë duke respektuar të drejtën ndërkombëtare, dua të kujtoj edhe se zgjidhja e problemit nuk mund t'i besohet vetëm përgjigjes ushtarake.

Është i nevojshëm një angazhim i fortë i përbashkët, i bazuar në besimin e ndërsjellë, që bën të mundur një paqe që zgjat dhe lejon më në fund që burimet të mos caktohen për armatimet, por për luftërat e vërteta të denja të njeriut: lufta kundër urisë dhe sëmundjeve, lufta për zhvillimin e mundshëm dhe mbikëqyrjen e botës së krijuar, në ndihmë të shumë formave të varfërisë dhe të mënjanimit që nuk mungojnë as në botën moderne.

Turqia, për historinë e saj, për arsye të pozitës së saj gjeografike dhe për arsye të rëndësisë që ka në rajon, ka një përgjegjësi të madhe: zgjedhjet e saj dhe shembulli i saj kanë një vlerë të veçantë dhe mund të jenë një ndihmë e madhe në favorizimin e takimit të qytetërimeve dhe në gjetjen e rrugëve më të praktikueshme të paqes dhe të përparimit të përnjëmendë.

I Tejetlarti e bekoftë dhe e mbrojtë Turqinë dhe e ndihmoftë atë që të jetë një autore e vlefshme dhe e bindur e paqes! Faleminderit!



PAPA FRANÇESKU NË TURQI

TAKIMI ME PATRIARKU EKUMENIK BARTOLOMEU I

Papa Françesku më 30 nëntor 2014, në festën e Shën Andreut, takoi në Stamboll Patriarkun Ekumenik Bartolomeu I dhe së bashku nënshkruan një deklaratë të përbashkët, që më poshtë vijon:

Ne, Papa Françesku dhe Patriarku Ekumenik Bartolomeu I, i shprehim mirënjohjen tonë të thellë Hyjit për dhuratën e këtij takimi të ri që na mundëson, në praninë e anëtarëve të Sinodit të shenjtë, të klerit dhe të besimtarëve të Patriarkatit Ekumenik, të kremtojmë së bashku festën e Shën Andreut, të thirrurit të parë dhe vëllait të Pjetrit Apostull. Kujtimi ynë i Apostujve, që ia shpallën lajmin e mirë të Ungjillit botës, nëpërmjet predikimit të tyre dhe dëshmisë së martirizimit, e forcon në ne dëshirën që të vazhdojmë të ecim së bashku me qëllim që t’i kapërcejmë, me dashuri dhe besim, pengesat që na ndajnë.

Me rastin e takimit në Jerusalem majin e kaluar, në të cilin kemi kujtuar përqafimin historik mes paraardhësve tanë të nderuar Papa Palit VI dhe Patriarkut Ekumenik Atenagora, kemi nënshkruar një deklaratë të përbashkët. Sot, me rastin e lumë të një takimi tjetër vëllazëror, duam t’i ripohojmë së bashku qëllimet dhe shqetësimet tona të përbashkëta.

Shprehim qëllimin tonë të sinqertë dhe të ngultë, në bindje ndaj vullnesës të Zotit tonë Jezu Krishtit, që t’i shtojmë përpjekjet tona për nxitjen e njësisë së plotë mes të gjithë të krishterëve dhe sidomos mes katolikëve dhe ortodoksëve. Gjithashtu, duam të mbështesim dialogun teologjik të nxitur nga Komisioni i Përzier Ndërkombëtar, që, i

themeluar tamam tridhjetë e pesë vjet më parë nga Patriarku Ekumenik Dimitrios dhe nga Papa Gjon Pali II këtu në Fanar, është duke trajtuar aktualisht çështjet më të vështira që kanë shënuar historinë e ndarjes sonë dhe që kërkojnë një studim të kujdesshëm dhe të thelluar. Me këtë qëllim, sigurojmë lutjen tonë të gjallë si Barinj të Kishës, duke u kërkuar besimtarëve që të bashkohen me ne në lutjen e përbashkët që «të gjithë të jenë një... që bota të besojë» (Gjn 17,21).

Shqetësim të përbashkët për situatën në Irak, në Siri dhe në krejt Lindjen e Mesme

Shprehim shqetësimin tonë të përbashkët për situatën në Irak, në Siri dhe në krejt Lindjen e Mesme. Jemi të bashkuar në dëshirën për paqe e stabilitet dhe në vullnesën për të nxitur zgjidhjen e konflikteve nëpërmjet dialogut dhe pajtimit. Duke i njohur përpjekjet e bëra tashmë për t’i dhënë ndihmë rajonit, njëkohësisht u bëjmë thirrje të gjithë atyre që kanë përgjegjësinë e fatit të popujve që ta shtojnë angazhimin e tyre për bashkësitë që vuajnë dhe t’u lejojnë atyre, përfshirë edhe ato të krishtera, që të mbeten në tokën e tyre të lindjes. Nuk mund ta pranojmë një Lindje të Mesme pa të krishterë, që aty kanë dëshmuar emrin e

Jezusit për dymijë vjet. Shumë vëllezër e motra janë përndjekur dhe janë detyruar me dhunë t’i lënë shtëpitë e tyre. Madje duket se ka humbur vlera e jetës njerëzore dhe se personi njerëzor nuk ka më rëndësi dhe mund të sakrifkohet për interesa të tjera. Dhe e gjithë kjo, në mënyrë tragjike, ndesh në mospërfilljen e shumë vetëve. Sikurse shën Pali na kujton: «Nëse vuan një gjymtyrë, vuajnë së bashku të gjitha gjymtyrët; e nëse nderohet një gjymtyrë, të gjitha gjymtyrët gëzohen bashkë me të» (1 Kor 12,26). Ky është ligji i jetës së krishterë dhe në këtë kuptim ne mund të themi se ka edhe një ekumenizëm të vuajtjes. Sikurse gjaku i martirëve ka qenë fara e forcës dhe e frytshmërisë për Kishën, po ashtu edhe bashkëndarja e vuajtjeve të përditshme mund të jetë një mjet efikas i njësisë. Situata e tmerrshme e të krishterëve dhe e të gjithë atyre që vuajnë në Lindjen e Mesme kërkon jo vetëm një lutje të vazhdueshme, por edhe një përgjigje të përshtatshme nga ana e bashkësisë ndërkombëtare.

Dialogu konstruktiv me Islamin

Sfidat e mëdha që bota ka përpara në situatën aktuale, kërkojnë solidaritetin e të gjithë

personave vullnetmirë. Prandaj, e pranojmë rëndësinë edhe të nxitjes së një dialogu konstruktiv me Islamin, të bazuar në respektin dhe miqësinë e ndërsjellë. Të frymëzuar nga vlerat e përbashkëta dhe të forcuar nga një ndjenjë e sinqertë vëllazërore, myslimanët dhe të krishterët janë të thirrur të punojnë së bashku për dashuri ndaj drejtësisë, paqes dhe respektimit të dinjitetit e të të drejtave të çdo personi, veçanërisht në

rajonet ku ata, dikur, kanë jetuar për shekuj në një bashkëekzistencë paqësore dhe tani vuajnë së bashku tragjikisht prej llahtarëve të luftës. Gjithashtu, si udhëheqës të krishterë, i nxisim të gjithë udhëheqësit fetarë që të vazhdojnë dhe të forcojnë dialogun ndërfeetar dhe të bëjnë çdo përpjekje për të ndërtuar një kulturë të paqes e të solidaritetit mes personave dhe mes popujve.

Kujtojmë edhe të gjithë popujt që vuajnë për shkak të luftës. Në veçanti, lutemi për paqen në Ukrainë, një Vend me një traditë të hershme të krishterë, dhe u bëjmë thirrje palëve të përfshira në konflikt që të kërkojnë rrugën e dialogut dhe të respektimit të së drejtës ndërkombëtare për t’i dhënë fund konfliktit dhe për t’u lejuar të gjithë ukrainasve që të jetojnë në harmoni.

Mendimet tona u drejtohen të gjithë besimtarëve të Kishave tona në botë, që i përshëndesim, duke iu besuar Krishtit Shëlbuesit tonë, që të mund të jenë dëshmitarë të palodhur të dashurisë së Hyjit. Ia drejtojmë lutjen tonë Hyjit që t’i japë dhuratën e paqes, në dashuri dhe në njësi, krejt familjes njerëzore. «Zoti që jep paqen, gjithmonë dhe në çdo mënyrë jua dhashtë paqen. Zoti qoftë me ju të gjithë» (2 Sel 3,16).



MATHEW FESTING I URDHKIT TË MALTËS VIZITON SHQIPËRINË

“Il Gran Maestro”, Mathew Festing, i Urdhrit të Maltës, erdhi në Shqipëri me datat 19-20 janar 2015, me rastin e 20-vjetorit të themelimit në Shqipëri të shoqatës “Malteser”. Me datën 19 janar ai ka pasur vizitat në Tiranë tek Presidenti, Kryeministri, Ministritë e tjera ...

Me datën 20 janar erdhi në Shkodër me këtë program: vizita pranë qendrës Malteser; një vizitë e shkurtër Kryetarit të Bashkisë; pashtaj takim me Imzot Angelo Massafrën, Bariun e Shkodrës dhe Presidentin

te Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë; dhe në fund një vizitë në Kuvendin e Klariseve dhe ish-burgun.

Dreka e përbashkët në restorant Colosseo dhe pas saj, te Salla e konferencës, një takim me vullnetarët dhe bashkëpunëtorët e Malteser-it dhe me të ftuarit, për të pëkujtuar 20-vjetorin e punës së Malteser-it në Shkodër. Rreth orës 15.30 u nis për Aeroport.

KOMUNIKATË PËR SHTYP NGA ESZTERGOM (HUNGARI)

Me datat 13-15 janar 2015 u zhvillua një mbledhje e Eprorëve të Kongregatës për Doktrinën e Fesë me Presidentët apo Përfaqësuesit e Komisioneve Doktrimore të Konferencave Ipeshkvnore Europiane në Qendrën Shën Adalberti në Esztergom, në zemrën fetare të Hungarisë. Morën pjesë, nga ana e Kongregatës për Doktrinën e Fesë, Kardinali Gerhard L. Müller, Prefekt, dhe Arqipeshkvi Luis F. Ladaria, S.I., Sekretar, të shoqëruar nga Atë Hermann Geissler, F.S.O., Kreu i Zyrës së Seksionit Doktrinor, dhe Imzot Christophe Kruijen, Zyrtar, dhe, nga ana e Komisioneve Doktrimore të Konferencave Ipeshkvnore Europiane, Kardinalët Péter Erdő (Hungari), Willem J. Eijk (Vendet e Ulëta), Dominik Duka, O.P. (Republika Çeke), Arqipeshkvijtë Angelo Massafra, O.F.M. (Shqipëri), Michael Neary (Irlandë), György-Miklós Jakubínyi (Romani), Paolo Pezzi, F.S.C.B. (Rusi), Philip Tartaglia (Skoci), Stanislav Zore, O.F.M. (Slloveni), Ipeshkvijtë Franz Scharl (Austri), Guy Harpigny (Belgjikë), Antoni Dziemianko (Bjellorusi), Tomo Vukšić (Bosnje-Hercegovinë), Valentin Pozaić, S.I. (Kroaci), Éric de Moulins-Beaufort (Francë), Karlheinz Diez (Gjermani), Philip Boyce, O.C.D. (Irlandë), Martin Drennan (Irlandë), Lucio Soravito De Franceschi (Itali), Andrzej Czaja (Poloni), Nuno Brás Da Silva Martins (Portugali), Ladislav Nemet, S.V.D. (Serbi, Mal i Zi, Maqedoni, Kosovë), János Pénzes (idem), Milan Lach, S.I. (Sllovaki), Adolfo González Montes (Spanjë), Yaroslav Pryriz, C.S.S.R (Ukraina e Bizantinëve), Imzot Jorge De Salas (Suedi, Danimarkë, Norvegji, Finlandë, Islandë), Imzot Patrick Burke (Skoci) dhe të Nderuarit Hector Scerri (Maltë) e Christopher Thomas (Britani e Madhe).

Në fillim të mbledhjes, Kardinali Müller lexoi një Letër të Papa Françeskut drejtuar pjesëmarrësve të takimit. Në këtë Letër Ati i shenjtë ka theksuar se nisma e përshtatshme “synon t’u japë rëndësi Ipeshkvijve vendorë, dhe në veçanti Komisioneve Doktrimore, në përgjegjësinë e tyre për njësinë dhe integritetin e fesë, si edhe për përcimin e saj brezave të rinj”. Duke iu referuar pastaj Nxitjes Apostolike Evangelii gaudium, ka uruar që mbledhja “të ndihmojë për të përballuar në mënyrë kolegjiale disa

vështirësi doktrimore e baritore, që paraqiten sot në kontinentin europian, me qëllimin që të nxitet te besimtarët një hov i ri misionar dhe një hapje më e madhe ndaj përmasës transhendente të jetës, pa të cilën Europa rrezikon ta humbë atë 'shpirt humanistik' që, pra, e do dhe e mbron”.

Më pas Prefekti i Kongregatës për Doktrinën e Fesë paraqiti një relacion të gjerë hyrës mbi “Natyren teologjike të Komisioneve Doktrimore dhe detyrën e Ipeshkvijve si mësues të fesë”. Ditën e parë u trajtuan disa tema të lidhura me unicitetin dhe universalitetin shpëtimtar të Jezu Krishtit, si edhe me shpalljen e Ungjillit si detyrë parësore të Kishës në Europë. Tematikat kryesore të ditës së dytë qenë çështjet e shtrua nga teoria “gender”, antropologjia e krishterë dhe liria fetare. Ditën e fundit u trajtuan disa çështje praktike të lidhura me ungjillëzimin e ri, sakramentin e

pendesës dhe funksionimin e një Komisioni Doktrinor. Bisedat u zhvilluan në një klimë përzemërsie të madhe dhe në një shpirt kolegjialiteti afektiv dhe efektiv. Secila temë u parapri nga një Relacion i përgatitur përkatësisht nga Kardinali Willem J. Eijk, nga Kardinali Peter Erdő, Imzot Luis F. Ladaria, Imzot Philip Tartaglia, Imzot Guy Harpigny dhe nga Imzot Adolfo González Montes. Këto ndërhyrje me autoritet u ndoqën nga një diskutim i gjallë dhe i frytshëm mes pjesëmarrësve.

Çdo ditë filloi me bashkëkremtimin eukaristik, të udhëhequr përkatësisht nga njëri prej Kardinalëve të pranishëm. Mbrëmjet

shërbyen edhe për të shkëmbyer opinione mbi situatën e përgjithshme të fesë në Europë.

Të gjithë pjesëmarrësit e vlerësuan mikpritjen e madhe të Kardinalit Peter Erdő, Primat i Hungarisë dhe President i Këshillit të Konferencave Ipeshkvnore të Europës, dhe të bashkëpunëtorëve të tij në Arkidioqezën e Esztergom-Budapestit.

Takimi ka qenë një rast për të përforcuar bashkëpunimin mes Komisioneve Doktrimore të Episkopateve të Vendeve europiane dhe me Kongregatën për Doktrinën e Fesë, me qëllim që të trajtohen me efikasitet gjithnjë e më të madh sfidat doktrimore të sotme në kontinentin europian.

PAPA FRANÇESKU NË MESAZHIN E PAQES

“Jo më skllavër, por vëllezër!”

Vijim i fq. 1

që janë të mbajtur në gjendje nënshtrimi”. Në veçanti, Papa u drejton “një thirrje urgjente të gjithë burrave dhe grave vullnetmirë, si dhe të gjithë atyre që, nga afër apo nga larg, edhe në nivelet më të larta të institucioneve, janë dëshmitarë të plagës së skllavërisë bashkëkohore”, duke i nxitur “që të mos bëhen bashkëpunëtorë të kësaj të keqeje” dhe “që të mos e kthejnë kokën nga ana tjetër përballë vuajtjeve të vëllezërve e motrave të tyre në njerëzim, të privuar prej lirisë dhe prej dinjitetit”.

Në mesazhin e Tij Papa Françesku bën një paraqitje të “fytyrave të shumta të skllavërisë” – punëtorë të pambrojtur, migrantë që nuk kanë të drejta, të mitur dhe të rritur të përfshirë në trafikimin e qenieve njerëzore dhe në prostitucion, gra të detyruara të martohen dhe të shitura për martesë... viktimat të grupeve terroriste. Papa kërkon që të luftohet kundër kësaj dukurie, në rrënjën e të cilës, ka kujtuar ai, “gjendet një konceptim i personit njerëzor që pranon mundësinë që ai të trajtohet si objekt”.

Ka një ton dramatik, por megjithatë të hapur ndaj besimit, mesazhi i ditës botërore për paqen që Papa Françesku ka dashur t’i drejtojë çdo burri dhe gruaje, pa dallim feje apo ideje. Dramatike është, në fakt, “dukuria e urryeshme” me të cilën Papa ka zgjedhur ta tërheqë

vëmendjen ndërkombëtare, domethënë plaga e shfrytëzimit të njeriut nga njeriu, deri në skllavëri. Me fjalë e fshirë, por me fakte e pranishme në shumë shoqëri dhe në forma shpesh të fshehta dhe të padukshme.

Shikimi i Papës është i rrënjësor në vizionin biblik, duke u bazuar te letra e Palit apostull drejtuar Filemonit ku i kërkon të rimarrë skllavin e ikur Onezim, por duke e pranuar jo më si skllav, por “porsi vëlla të dashur”.

Në fund Papa Françesku falënderon shumë Kongregatat Rregulltare, sidomos ato femërore, d.m.th. janë murgeshat që prej shumë vitesh punojnë dhe ndihmojnë viktimat, në pjesën më të madhe të tyre gra e fëmijë, duke u kujdesur për ta, duke i rehabilituar, duke i reintegruar në shoqëri, si cili hpesh është i vështirë. Papa Françesku bën një thirrje: “është e nevojshme të njihet roli i gruas në shoqëri”.

Të dashur, Viti i ri, me hirin e Hyjit, le të jetë vit paqeje për çdo njeri, për ato familje që vuajnë prej mungesën së paqes, për Shkodrën, për Shqipërinë, për Tokën e shenjtë dhe për mbarë botën.

Nga zemra ju falënderoj të gjithëve për praninë dhe uroj që viti 2015 të jetë vit më i mbarë për Shkodrën dhe për Veriun. Përshumëvjet!”

Vladimir Banushi

KRISHTLINDJE NË TOPLANË E DUSHMAN



Vendosëm ta kalonim Krishtlindjen në Shqipëri, në Melgushë (Shkodër) pranë Motrave Françeskane të Bamirësisë, duke i ndihmuar në animacionin kateistik. Pas natës së udhëtimit me traget, në agim, arritëm në Durrës më 26 dhjetor 2014, ditën e Shën Shtjefnit. Nga porti marrim një furgon dhe pas dy orëve arrijmë te shtëpia e motrave.

Na presin Motër Mina, Motër Roza dhe Motër Ana. Ato janë duke u përgatitur për ne. Stufa në këtë shtëpi është gjithmonë e ndezur, përreth së cilës ngrohtësia është përqafim, qeshje, lutje. Melgusha është një fshat me pak rrugë dhe pak shtëpi, pak njerëz në rrugë, rrugë të lagura, një gjuhë e huaj dhe të paktën dy besime në hapësirën e pak kilometrave katrorë. Motrat janë këtu prej kohësh. Sjellin Krishtin në këtë luginë të vogël. Është Krishtlindje në kuptimin e vërtetë të fjalës, është një lindje e bashkimit, e gëzimit të thjeshtë, përbërë prej pak gjërash, por të çmueshme. Pasdite kemi orator. Arrijnë pak fëmijë, njihemi me emrat e tyre, të rinj për nga tingulli, dhe me sytë e tyre të shkëlqyeshëm. Sidorela, Eglantina, Edmonda, Luigi, Donaldi... ditët më pas do të bashkohen edhe

Paolo, Denisi, Pjerini, Gabrieli si edhe shumë të tjerë. Me ta argëtohem duke mësuar shqiptimin e fjalëve dhe duke qeshur për faktin se si e shtrembërojmë atë ne italianët, vizatojnë fytyrat tona ashtu siç dinë, me bukuri të pastër, shumë të pastër; e pastaj luajmë, me pafajësi dhe bashkëpunim. Ja misioni, ja takimi, që nuk ka nevojë për shumë mjete. Sa shumë rritet njeriu në minutat e shpenzuara për të kuptuar hapat e një valleje në dy gjuhë të ndryshme? Përgjigjja është “shumë” dhe jemi të vetëdijshëm se gjërat e rëndësishme, në kalimin tonë në tokë, nuk përbëhen nga gjeje të mëdha, por nga gjeje të vogla që mund t’i bëjnë të gjithë. Këtë u predikonte Krishti, në kryq, të urtëve të tempullit, në fjalimet në male, në lutjet në kopshtet e ullinjve. Buka e përditshme është ky ushqim i privilegjuar që gjendet në sytë e atyre që kemi përpara, të atyre që na lejojnë të dalim prej vetvetes dhe na lirojnë.

Gjatë ditëve në Shqipëri jetuam në thjeshtësi dhe në gëzim. Në meshët në gjuhën shqipe nga të cilat arritëm të kuptonim momentet e ndryshme pavarësisht prej pengesës gjuhësore, në ecjen për një ditë të tërë në makinë, në varkë, në këmbë dhe në borë për të arritur kishën e Toplanës dhe për të kremtuar një pagëzim, në kushtimin e hapave tanë një qielli mbi madhësinë e të cilit ndoshta nuk do të kishim vënë kurrë bast. E kuptuam në urtinë dhe në qetësinë e Motër Rozës, ndërsa përgatiste ushqimin, në freskinë rinore të Motër Anës që, sikurse ne, është në ecje zbulimi, në zjarrin e Motër Minës që i ngjan shumë një vatre: një vend që ka ngrohtësi dhe e përhap atë, falas, dhe entuziazmon ata që ka pranë. Në vërtetësinë me të cilën fëmijët dhe të rinjtë e oratorit e jetojnë gëzimin e takimit me ne që vijmë nga larg, ata që argëtohen dhe entuziazmohen për pak gjë, qofshin 8-vjeçarë apo 15-vjeçarë dhe ne që duke pranuar natyrshmërinë e tyre mendojmë për atë natyrshmëri që shumë herë bashkëmoshatarët e tyre italianë e kanë humbur. Në mahnitjen e syve të Eglantinës kur i themi se malet ku banon shihen nga Italia, nga vendi prej të cilit ne vijmë, në ditët kur qielli është i kthjellët. Në fjalët e ipeshkvit që në drekë na tregon se çfarë do të thotë të ungjillëzosh në një tokë ku gjenden disa besime, në rrugët e një qyteti – Shkodrës – në të cilat shumë gjëra janë të reja dhe kanë zënë vendin e atyre të vjetrave dhe çdo cep është udhëkryq, jo vetëm drejtimesh, por edhe epokash, kulturash, historish,

Vijon në fq.12

HAPJA E VITIT TË “JETËS SË KUSHTUAR” NË SHKODËR

Më 13 dhjetor 2014 në katedralen e Shkodrës u bë hapja zyrtare në nivel kombëtar e Vitit të Jetës së Kushtuar, dëshiruar prej Papa Françeskut duke filluar nga 30/12/2014 deri më 02/02/2016. Tre janë objektivat e propozuar: të falënderojmë, të jetojmë dhe të shpresojmë: Ta shikojmë të kaluarën me mirënjohje, ta jetojmë të tashmen me pasion, ta përqafojmë të ardhmen me shpresë. Në manifest, me logon e zgjedhur për këtë vit të veçantë, një pëllumb hukat mbi ujërat, me fjalët “ungjill, profeci dhe shpresë”. Është Shpirti Shenjt që e pasuron Kishën me dhuratat dhe jep karizmat. Në fillim të kremtimit Atë Giovanni Peragine, president i Kshel-it kombëtar (organizëm që mbledh të gjithë rregulltarët e rregulltaret në Shqipëri), pas përshëndetjes drejtuar pjesëmarrësve, shpjegoi domethënien që Papa Françesku ka dëshiruar t’i japë këtij viti të jetës së kushtuar. Edhe arqipeshkvi Imzot Angelo Massafra, që udhëhoqi kremtimin, theksoi rëndësinë e madhe të këtyre tri fjalëve udhërrëfyese për çdo të kushtuar të thirrur që të formohet prej fjalës, ta paraqesë atë në kohën tonë, të japë shenjat e risisë për një botë të re dhe të ndryshme, në të cilën Krishti duhet të jetë gjithmonë qendra e jetës dhe e veprimit tonë.

Pjesëmarrja nga ana e rregulltarëve qe shumë e madhe: kishin ardhur nga e gjithë Shqipëria, nga veriu në jug, dhe kishin mbushur çdo cep të katedrales. Me Imzot Angelo Massafra arqipeshkëv të dioqezës së Shkodër-Pult dhe President të Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, bashkëkremtuan edhe Nunci Apostolik Imzot Ramiro Moliner Ingles, Imzot Lucjan Avgustini nga Sapa, Imzot Ottavio Vitale nga Lezha, Imzot Cristoforo Palmieri nga Rrësheni dhe Imzot George Frendo nga Tirana, mëse 97 meshtarë. Më shumë se 500 ishin rregulltaret e pranishme nga të gjitha kongregatat në Shqipëri. Kshel-i kombëtar, nëpërmjet Dom Rolando Redës, Orionin, dhe Motrës Marieta Lushi, Stigmatine, kishin përgatitur kremtimin me këngët, lutjet e besimtarëve,

leximet, etj. Secilës dioqezë iu dhurua ikona e Shndërrimit dhe një llambë, që secili do ta vërë në një pikë të përshtatshme të katedrales së vet, duke kujtuar fjalët e Pjetrit në Tabor “Është mirë për ne të rrimë këtu”, dhe e cila duhet mbajtur gjithmonë e ndezur pranë tabernakullit. Më pas të gjithë kaluan në sallën “Kardinal Mikel Koliqi” ku bashkësitë rregulltare të Shkodrës, si dioqezë mikpritëse, ofruan një koktejl, të përgatitur nga secila kongregatë, për gëzimin e të gjithëve. Fillimi qe i bukur, vazhdimi është në duart dhe në zemrat e të gjithëve, në mënyrë që të mbillet me begati dhe të mund të korret me gëzim.

Dom Rolando Reda



JETË E RE ME ZOTIN NË FAMULLINË E SHKRELIT

Shën Agostini ka thënë "nëse jam asgjë pa Ty, jam gjithçka me Ty". Për famullinë, kjo gjithçka do të thotë që Zoti është Udhë, e Vërteta dhe Jeta. Pa Zotin asgjë s'ka kuptim. Tani famullia jonë me ndihmën e Dom Nikolinit po ecën drejt një jete të re me Zotin duke formuar në famulli grupet rinore.

Në famulli rinia po kalon momente të paharrueshme. Ajo që ia vlen të veçohet është pikërisht e Diela e Dytë e Ardhjes. Në atë ditë të bashkimit me Zotin në darkën e Tij u bë kungimi i parë i disa fëmijëve të famullisë sonë. Këta fëmijë që morën kungimin e parë bashkimi me Jezusin ua shtoi gëzimin. Në sytë e tyre shihej një shkëlqim, në fytyrat e tyre shihej një lumturi e madhe dhe kishin një buzëqeshje të mrekullueshme. Ne morëm një kënaqesi të madhe nga ai moment dhe u uruam këtyre fëmijëve një jetë të lumtur me Jezusin në zemër.

Gjatë predikimit dom Nikolini theksoi rëndësinë e prindërve në rrugën që do të përshkojnë fëmijët drejt takimit me Zotin duke theksuar se pajtimi me njëri-tjetrin ndihmon bashkimin tonë me Zotin.

Famullia jonë përjetoi momente shumë të bukura të Dielën e Tretë të Ardhjes duke pritur bariun shpirtëror Imzot Angelo Massafra. Gjatë kremtimit të meshës Imzot Angelo ua shpërndau sakramentin e



krezmimit 18 të rinjve. Prania e Arqipeshkvit e gëzoi shumë famullinë tonë. Porosia që na la Imzot Angelo ishte që ta jetojmë çdo ditë ungjillin duke shijuar paqen e Zotit.

Një ndër aktivitetet e tjera që u zhvilluan në famullinë që festa e quajtur "Festa e kaqimkut", që u zhvillua të shtunën më 20 dhjetor 2014. Nga të gjitha fshatrat e famullisë u grumbulluan të gjithë fëmijët duke i dhënë një gjallëri ambjenteve të famullisë. Festa filloi me Meshën e shenjtë duke i drejtuar lutjet tona Zotit, që të rritemi me ndihmën e tij. Gjatë këtij aktiviteti u bënë shumë lojëra të ndryshme dhe u bashkëndanë shumë gjëra të

bukura. Gjatë drekës e shijuam edhe kuzhinën tradicionale të përgatitur nga të rinjtë e famullisë.

Kjo ishte një ditë e paharrueshme. Së fundi, falënderojmë Zotin për këto momente të bukura që na i ka dhënë dhe që vazhdon të na i japë

dita-ditës. Gjithashtu falënderojmë dom Nikolinin, i cili së bashku me animatorët, punon në mënyrë të vazhdueshme dhe pa u lodhur me fëmijët dhe të rinjtë e famullisë sonë.

Faleminderit, o Zot, që me ndihmën e Dom Nikolinit na mësove se sa e bukur është jeta me Ty dhe se Ti je forca dhe shpresa e secilit prej nesh. Faleminderit, o Zot, që me këto dy rreshta na jep mundësinë që bashkëmoshatarëve tanë t'u urojmë Gëzuar Krishtlindjen dhe Vitin e Ri 2015 në emër të famullisë Shkrel-Bogë.

Diana Pepaj dhe Majlinda



LUTJA E PAPA FRANÇESKUT PËR SINODIN MBI FAMILJEN

O Jezus, Mari e Jozef,
në ju sodisim
shkëlqimin e dashurisë së vërtetë,
juve ju drejtohem me besim.
O Familja e shenjtë e Nazaretit,
bëji edhe familjet tona
vende të bashkimit dhe çenakuj të
lutjes, shkolla të vërteta të Ungjillit

dhe kisha të vogla shtëpiake.
O Familja e shenjtë e Nazaretit,
kurrë më në familje të mos përjetojen
dhuna, mbyllja dhe ndarja:
kushdo është plagosur apo shkandulluar
le të njohë shpejt ngushëllimin
dhe shërimin.
O Familja e shenjtë e Nazaretit,

Sinodi i ardhshëm i Ipeshkvijve
zgjoftë në të gjithë vetëdijen
e karakterit të shenjtë dhe të pacenueshëm
të familjes,
bukurinë e saj në planin e Hyjit.
O Jezus, Mari e Jozef
dëgjojeni dhe plotësoheni lutjen tonë.
Amen.

PAPA FRANÇESKU NË SRI LANKA DHE NË FILIPPINE

Papa Françesku bëri Udhëtimin Apostolik në Sri Lanka dhe në Filippine, duke u nisur nga Roma më 12 janar dhe duke u kthyer më 19 janar 2015. Më 13 janar pas arritjes në Colombo pati takimin me Autoritete Shtetërore, Presidentin e Republikës, me Ipeshkëvinj, takimin Ndërfetar, Meshën e shenjtë me kanonizimin e të Lumit Giuseppe Vaz dhe lutjen drejtuar Zonjës Mari në Shenjtëroren e Zojës Ruzare.

Më 15 janar në orë 18 arriti në Manila dhe pas mirëseardhjes, të

nesërmen vazhdoi programin: vizitën tek Presidenti, takimin me Autoritet dhe me Trupin Diplomatik, Meshën e shenjtë me Ipeshkvinj, Meshtarë Rregulltarë dhe Rregulltare, me Familjet, drekën me disa nga të mbijetuarit e fortunës "Yolanda", bekimin e "Pope Francis Center for the Poor", me Meshtarë, Rregulltarë, Rregulltare, Seminaristë dhe Familjet e të mbijetuarve, me Liderit Fetarë të Filippineve, me të rinj.

Në fund: Mesha e shenjtë në "Rizal Park" në Manila dhe nisja nga Manila për në Romë.

JAVA EKUMENIKE: “MË JEP TË PI!”

Nën temën “Më jep të pi!” (Gjn 4,7), propozuar prej komisionit ekumenik brazilian, që lindi si përgjigje e thjeshtë ndaj situatave fetare të krijuara në atë vend, u mbajt në qytetin tonë java e lutjes për bashkimin e të krishterëve. Të shtyrë prej kësaj nxitjeje ungjillore dy bashkësitë e krishtera të qytetit të Shkodrës, ajo Katolike dhe Ortodokse, u mblodhën së bashku për t'u lutur për njësimin e të krishterëve, të frymëzuar kryesisht prej Krishtit që dëshiron që të gjithë të jenë një dhe të drejtuar prej një Bariu të vetëm.

Të martën, më 20 janar 2015, në orën 17.00, tek kisha katolike e Shën Kollit në Rus, u kremtua lutja e mbrëmësore nën drejtimin e Sh. T. Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkvi ynë, i ndihmuar gjithashtu edhe prej seminaristëve të Seminarit Ndërdioqezan. I pranishëm qe edhe Atë Nikolla Petani, prift i Kishës Ortodokse në Shkodër, si edhe shumë besimtarë të tjerë nga të dyja bashkësitë. Në fjalën e rastit Arqipeshkvi theksoi më së shumti domethënien e vërtetë të temës së zgjedhur për javën e lutjes për bashkimin e të Krishterëve, e cila -sipas Tij- përmban në vetvete takimin e dy realiteteve: dëshirën e hyjnore për të hyrë në kontakt me njerëzoren dhe nevojën e njerëzores për t'u përfshirë prej saj. Në thelb -pohoi Imzot Massafra- është Krishti ai që i shkon në takim Samaritanes dhe kërkon prej saj ujë; Jezusi kërkon, ka etje për ne, na do pranë, dëshiron të na shohë të bashkuar rreth tij dhe për të. Nuk heziton të na afrohet, është në kërkimin tonë e na fton edhe ne për të hyrë në këtë logjikë, e cila ngjall tek çdo njëri dëshirë për komunikim. Në fakt, takimi mes tyre nuk ishte asgjë tjetër përveçse bisedë, qëndrim së bashku, marrëdhënie e ndërsjellë e formuar prej një dialogu shembullor; gjë të cilën edhe ne jemi të ftuar ta ndërmarim. Po ashtu -vijoi Ipeshkvi - kjo etje e dyanshme le të nxisë në ne dëshirën për të dialoguar dhe për të shqyrtuar në brendësinë tonë nevojën për të qenë dëshmitarë të njësimin e të bashkimit vëllazëror, që shuan etjen e Krishtit e që shënon marrëdhënie shembullore dashurie për njerëzimin e plagosur e të ndarë që jeton në botën e sotme.

Ndërsa Atë Nikolla, në fjalën e tij përshëndetëse, duke vijuar në të njëjtën linjë, nënvizoi së shumti marrëdhëniet e mira ndërfitare që

ekzistojnë në vendin tonë, të cilat edhe në sy të Papa Françeskut, dukeshin frymëzuese dhe inkurajuese për shumë vende të botës së krishterë! Për më tepër - vijoi ai- njësimi mes nesh do të fillojë të bëhet i dukshëm dhe më spikatës nëse secili prej nesh do ta shohë tjetrin si vëlla e jo si gabues apo si “ai i fesë tjetër”, por si pjesëtar dhe gjymtyrë e të njëjtit Trup të Krishtit Zot.

Ndërsa lutja javore po ecte në normalitetin e saj, ritmi i kohës na solli në një takim tjetër së bashku. Lutja është ajo që si karakteristike të saj nuk ka vetëm lidhjen me Hyjin, por edhe krijimin e marrëdhënieve ndër-vëllazërore mes njëritjetrit. Prandaj të shtyrë prej këtyre ndjenjave të posaçme ditën e premte, më 23 janar 2015, në kishën Ortodokse u mbajt dita e dytë e lutjes për bashkimin e të krishterëve. Kisha u mbush plot me praninë e besimtarëve, të cilët të



drejtuar prej zërit të Popit që këndonte, i thurnin lavdi Hyjit të madhërishtëm, Perëndisë së qiellit, që të pranonte kërkesat e tyre për bashkim e njësim. Pastaj Atë Nikolla i shtyrë prej fjalëve të Ungjillit të lexuar, shprehu dëshirën që banon tashmë prej kohësh në zemrat e të krishterëve: që të gjithë të jemi një në Krishtin Zot, e së bashku të kemi mundësi për t'u lutur e për t'u ushqyer në sofrën eukaristike që Perëndia e shtron për ne.

Mes fjalëve të tij dhe të Imzot Angelo Massafres, u përmbyll edhe kjo javë lutjeje, me dëshirën e bindjen se secili prej nesh të marrë detyrën që i takon: d.m.th. të lutet vazhdimisht që Ati Zot të ndreqë përçarjet e të ndërtojë njësinë.

Pohon psalmisti: “Sa bukur është kur vëllezërit qëndrojnë së bashku!” Në këto ditë, kjo bukuri ka reflektuar në secilin prej nesh, e sidomos në momentin kur njëzëri, nën lutjet shigjetore dhe të drejtuar prej barinjve tanë, brohoritëm kah Hyji: “Mëshirë, o Zot!”, dhe me duart e bashkuara të udhëhequr shpirtërisht prej Birit, si bij e si vëllezër iu lutëm Hyjin, Atin tonë qiellor duke thënë lutjen “Ati ynë”. Hyji na drejtoftë dhe çdo lutje dhe dialog ekumenik i yni u bëftë për më të madhen lavdi të tij!

Gaspër Kolaj, viti II, Teologji

3 DHJETORI, DITA NDËRKOMBËTARE E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA



“Projekti Shpresa”, tashmë sipas traditës, organizoi një mbrëmje letraro-artistike me temë: “Festojmë së bashku”, duke grishur për pjesëmarrje edhe fëmijët e komunitetit Rom, grupin e valleve të vajzave të motrave të “Nënë Terezës”, si dhe fëmijët e shoqatës “Gruaja në Zhvillim”. Veprimtaria u zhvillua tek salla “Kardinal Mikel Koliqi”. Një falënderim i veçantë i takon famullitarit të Kishës së Shën Shtjefnit, Dom Artur Jakut, i cili me dashamirësi mundësoi debutimin në këtë ambjent.

Për organizimin dhe realizimin e kësaj veprimtarie dhanë kontribut të vyer dhe treguan përkujdesje të posaçme stafi drejtues me në krye presidentin e shoqatës z. Luigj Mila, anëtarët e bordit, kujdestarë dhe edukatorë. Agjentët kryesorë në realizimin e kësaj veprimtarie janë dhe mbeten përherë të rinjtë e “Projektit Shpresa”. Ata vetë, me guxim artistik performuan përpara publikut me pjesë të ndryshme të përzgjedhura nga autorë dhe mendimtarë në zë, siç janë Khalil Gibran, Nënë Tereza, Frank Sheed e të tjerë.

Këta të rinj, përtej problematikave të tyre, gjatë përgatitjeve për debutim u treguan të vullnetshëm dhe të zellshëm për të përballuar

Vijon në fq.8

KRISHTLINDJE 2014 NË BREG LUMI - DUKAGJIN

Këtë vit pata gëzimin t'i bashkohesha një grupi që tashmë çdo vit e kalon Krishtlindjen mes fshatrave të Dukagjinit – një krahinë malore në Veri të Shqipërisë – ku me thjeshtësi dhe me krenari jeton një pjesë e popullsisë që arriti të mbetej e lirë dhe e pavarur, për të mbrojtur fenë katolike dhe identitetin e vet prej pushtimit turk, që filloi në shekullin XV dhe zgjati deri në vitin 1912.

Grupi i udhëtarëve, përveç meje, këtë herë ishte i përbërë nga fra Antonio Imperato, misionar dhe sekretar i Misioneve të huaja të Kapuçinëve të Puljas; fra Domenico Mirizzi, misionar në Mozambik; Carmela Zaza, përgjegjëse e projektit Dukagjin; Cosmo Coppolecchia një i ri laik që i do misionet. Për të gjithë, përveç fra Antonios, Carmela-s dhe Angjelinit, një student shqiptar që na priste në Shkodër dhe ndihmon me përkthimet, ishte hera e parë në Dukagjin.

Edhe për ne udhëtimi qe i gjatë: u nisëm nga Bari rreth mesnatës së datës 23 dhjetor për të arritur në destinacion në orën 18.30 të së nesërme. Por qe një udhëtim fantastik që na dha mundësinë të shijonim ngrohtësinë e miqësisë, të pasuroheshim me praninë e Zotit në jetët e të tjerëve, të zhvisheshim prej sigurive tona dhe t'i besoheshim Provanisë. Po, sepse udhëtimi për në Dukagjin në dimër nuk është kurrë i sigurt, është gjithmonë një aventurë. Për të arritur atje nga Shkodra duhen rreth 5-6 orë me fuoristradë; duhet të kalohet një pjesë malore 1.600 m në rrugë jo të asfaltuara, pa mbrojtje anësore, me humnera të mahnitshme. Mjafton të bjerë borë për të izoluar krejt luginën e Dukagjinit e për të mos qenë e mundur të arrihet atje. Në rastin tonë qemë me fat, nuk pati borë kur po shkonim, vetëm pak akull (kundër të cilit përdorëm zinxhirët) dhe, për befasinë e madhe të atyre që kishin qenë më parë,

rruga e asfaltuar nga Shkodra deri në pikën më të lartë të zonës.

Kur arritëm në kishën e Breg Lumit, në luginën e Shalës, ku na u desh ta linim makinën për të vazhduar në këmbë, tashmë ndihej atmosfera e Krishtlindjes së Betlehemit. Nuk ka ndriçim, pemë Krishtlindjesh, dyqane plot me objekte të shkëlqyeshme e të kota, trafik apo ankth për të blerë në minutën e fundit dhuratat që duhen vënë nën

pemë. Praktikisht, mungon gjithçka me të cilën qytetërimi e ka mbështjellë Krishtlindjen.

Pasi zbritëm nga fuoristrada, në terrin e natës, u gjendëm të zhytur në një grazhd natyror dhe admiruam bukurinë e botës së krijuar: qielli ishte një mantel i mrekullueshëm yjesh, në heshtjen e luginës jehonte zhurma e një përroi aty afër dhe në malet që na rrethonin, pak drita të zbehta tregonin shtëpitë e fshatrave dhe zbulonin pritjen e Jezusit Zoti në familjet. Duke na pritur pranë kishës ishte Pashkoja, i biri i Lulashit tek i cili do të ishim mysafirë. Një gomar do të barte çantat tona deri te shtëpia e të atit ku e gjithë familja ishte duke na pritur. Për të arritur atje nuk ka rrugë; çdo shtëpi arrihet vetëm duke

përkthyer shtigje mali. Në rastin tonë ecëm në të përpjetë për rreth një orë, duke kaluar ura prej druri të varura me litarë mbi lumë, livadhe të mrekullueshme të mbuluara me brymë të ngrirë, pyje dhe panorama shkëmbore, përrunj ujë që prishin heshtjen e një natyre të mahnitshme.

Duke na pritur me një kandil me gaz, te dera e oborrit, gjendej kryetari i familjes, Lulashi, mik i fra Antonios. Që prej atij momenti të gjithë filluan të kujdeseshin për ne, duke e bërë shtëpinë e tyre shtëpi tonën, familjen e tyre familje tonën, duke e kapërcyer ku e ku thëniën: “Shtëpia e shqiptarit është e Zotit dhe e mikut. Ai gjithmonë është i gatshëm t'i japë bukë, kripë e shtrojë, së bashku me zemrën e mirë, atij që

Vijon në fq. 10

3 DHJETORI, DITA NDËRKOMBËTARE E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Vijim i fq. 7

trysninë e skenës, së cilës iu përgjigjën me thjeshtësinë dhe sinqeritetin që i karakterizon.

Falë “Qendrës Ditore”, tashmë një laborator artistik i mjediseve të “Projektit Shpresa”, u zhvilluan prova intensive për të arritur kriteret e dëshiruara. Pikërisht në këtë qendër, të rinjtë e kësaj shoqate i nënshtrohen art-terapisë, e cila rrok në gjirin e saj dramë-terapinë, dance-terapinë, muzikë-terapinë dhe shumë nëndegë të tjera. Meqenëse arti priret të sublimojë dhe optimizojë, përmes tij të rinjtë tanë gjejnë kënaqësinë e ekuilibrit psiko-emocional dhe afektiv. Nëpërmjet artit u jepet mundësia të kanalizojnë energjitë dhe të zhdërvjelltësojnë shprehitë e mpira.

Strukturat e shëndetshme, angazhimi i plotë i personelit, si edhe përkujdesjet e pareshtura, kanë bërë që jeta e të rinjve të kësaj Shoqate të njohë progres dhe rritje të pandërprerë.

Vëmendja e përhershme e Kishës u jep ngrohtësinë dhe dashurinë e

Hyjit. Të rinjtë tanë ndjekin rregullisht Meshën, këndojnë këngë fetare dhe flasin me dëshirë për besimin e tyre ndaj Hyjit, çka tregon se në vetëdijen e tyre Hyji është i pranishëm.

Duke iu rikthyer aktivitetit letrar-artistik, mori pjesë një publik vërtet i admirueshëm. Na nderuan me praninë e tyre Imzot Angelo Massafra, ku për kënaqësinë e të gjithëve mbajti fjalën përshëndetëse. Gjithashtu e pranishme ishte edhe znj. Eleni Zorba, përfaqësuese e Bashkisë Shkodër, etj.

Shpresojmë që në të ardhmen të kemi një ndjeshmëri shtetërore gjithnjë në rritje, në mënyrë që jeta e

këtij kontigjenti të gëzojë përkrahje të plotë nga strukturat përkatëse. Nuk mund të vetëkufizohemi duke i klasifikuar të tjerët si të kufizuar, pasi dinjiteti është vetëm një, ai njerëzor.

Tomi Delija



DOM GIUSEPPE BARBATI SHUGUROHET MESHTAR

“PO, ME NDIHMËN E ZOTIT, DUA”

Me këtë pohim kremtor, të mërkurën më 28 janar 2015 dom Giuseppe Barbati, diakon I dioqezës Shkodër-Pult, ka dhënë miratimin e vet për të marrë përsipër angazhimet përkatëse të Urdhrit të Presbiteratit.

Ka ardhur në këtë moment të shumëpritur pas një itinerari të gjatë që e ka parë fillimisht si student të Teologjisë në Dioqezën Rossano-Cariati, në tokën e vet të prejardhjes në Kalabri, pastaj ka vazhduar studimet si Seminarist pranë Dioqezës Frëjus-Toulon (Francë), ku ishte transferuar bashkë me familjen, pastaj e ka përfunduar formimin e vet teologjik në Romë. Së fundi, në janar të vitit 2013, zgjedhja misionare e ka sjellë në Shqipëri, popull me të cilin bashkëndan prejardhjen, pasi ai i përket etnisë arbëreshe. Ka filluar të përmirësojë gjuhën shqipe, është angazhuar në mësimdhënie pranë Seminarit Teologjik të Shkodrës, në qershor 2014 është shuguruar Diakon dhe ka kryer punë të ndryshme baritore në qytet dhe në fshatrat përreth.

Ky ka qenë itinerari i tij formativ, duke lexuar të cilin, shumë vetë do të ishin të prirur të mendojnë se kremtimi i Sakramentit të Urdhrit të mërkurën më 28 janar ka qenë pikëarritja e tij. Në të vërtetë, është kështu vetëm pjesërisht sepse është e vërtetë se Shugurimi Presbiteral arrin pas një itinerari të gjatë përgatitjeje njerëzore, shpirtërore e teologjike, por shugurimi meshtarak është vetëm fillimi i një historie personale të përngjasimit me Krishtin Meshtar, që do të përfundojë vetëm në fund të jetës. Me Sakramentin e Urdhrit merret autoriteti i lidhur me Sakramentin, por ajo që e bën një njeri presbiter është gatishmëria e vazhdueshme ndaj veprimit të Shpirtit Shenjt që të kryejë përngjasimin e përsosur me të vetmin Kryeprift të Amshuar, që është Jezusi (krh. Heb 4,14).

Në lidhje me këtë është mirë të sqarojmë para së gjithash se Sakramenti nuk është një veprim “magjik”, që e shndërron dikë në diçka; prandaj nuk e mbron personin nga gabimet njerëzore, madje, është një “visar në enë argjile” (krh. 2 Kor 4,7) që duhet ruajtur dhe mbrojtur.

Në radhë të dytë, meshtari është bir i një Kise të veçantë, ku dinjiteti i përbashkët jepet prej Pagëzimit; në këtë kuptim presbiteri, në mes të popullit të vet, zgjidhet si drejtues i vetë popullit në ecjen e përbashkët të shenjtërisë që çon drejt Hyjit.

Duke nisur prej këtyre dy vetëdijeve kuptojmë dinjitetin e madh dhe bukurinë e madhe të meshtarisë së krishterë dhe njëkohësisht brishtësinë e saj të madhe. “Dinjitet” sepse një njeri bëhet i ngjashëm me Krishtin Meshtar dhe është i thirrur të drejtojë popullin e Hyjit në ecje. “Brishtësi”, sepse ngjashmëria me Krishtin nuk e asgjëson të qenët e tij “njeri”, dhe prandaj gjithmonë i nënshtroar ndryshimeve të shkaktuara

prej natyrës njerëzore. Pra, pikërisht për këto arsye, kemi ndier detyrën të lutemi për dom Giuseppe-n, për ta shoqëruar atë në këtë itinerar të bukur që, pikërisht për bukurinë e tij është edhe shumë angazhues. Prandaj Shugurimi i tij Presbiteral është përgatitur nga një Treditësh lutjeje.



Më 25 janar, e diel dhe festa e Kthimit të Sh. Palit, në përfundim të Meshës së shenjtë të pasdites është kujtuar me një moment lutjeje dhe me projektimin e një filmimi përvjetori i pranisë së Zojës së Fatimës në Dioqezën tonë. Maria është Nëna e Meshtarëve: Asaj Jezusi që po vdiqte ia ka besuar nxënësin e dashur dhe nxënësit i ka besuar Nënën. “Prej asaj ore nxënësi e mori me vete” (Gjn 19,27): i urojmë dom Giuseppe-s që ta ketë gjithmonë me vete, në shtëpinë e vet, Nënën e Jezusit dhe të Kishës.

Më 26 janar, ata që e rrethuan dom Giuseppe-n dhe i lartësuan Zotit lavdet e mbrëmësore qenë të rinjtë që kishin ardhur pranë kishës së Shën Kollit në Shkodër. Thirrja është një dhuratë që nuk merret për vetvete, por duhet komunikuar dhe bashkëndarë. Kështu, në atë rrethanë, dom Giuseppe dha edhe dëshminë e vet në lidhje me thirrjen, duke ripërkthyer etapat e ecjes së vet dhe duke u shpallur të gjithëve bukurinë e të qenët në ndjekje të Jezusit.

Së fundi, të martën më 27 janar, në përfundim të Kremtimit eukaristik të udhëhequr nga Arqipeshkvi, dom Giuseppe publikisht bëri dëshminë e vet të fesë para kremtimit të Sakramentit të Urdhrit dhe, së bashku me të, populli i Hyjit adhuroi Jezusin Eukaristik që, në soditjen e Atij që bëhet vazhdimisht

dhuratë për ne, dom Giuseppe të gjejë forcën e nevojshme për shërbesën meshtarake dhe ngushëllimin në momentet kyç të misionit të vet.

Të mërkurën më 28 janar qe data e zgjedhur për kremtimin e Sakramentit, sepse është dita në të cilën Kisha përkujton Shën Tomën e Akuinit, mësues i shenjtë i Kishës me të cilin dom Giuseppe është i lidhur në mënyrë të veçantë. Kremtimi qe shumë festiv dhe momentet e veçanta të ritit u jetuan me pjesëmarrje të madhe nga besimtarët dhe meshtarët e shumtë që iu bashkuan Imzot Massafres në thirrjen drejtuar Shpirtit Shenjt, në shtrirjen e duarve mbi kokën e kandidatit për meshtar dhe në përqaftimin e mirëpritjes së dom Giuseppe-s në Presbiterin e dioqezës së Shkodër-Pult. Përveç porosive që Arqipeshkvi i drejtoi atij gjatë homelisë së kremtimit, është e drejtë që dom Giuseppe të ketë edhe mbështetjen e lutjes së përditshme të krejt Kishës dioqezane. Urime, dom Giuseppe. Ad multos annos. Të shoqërojmë me lutjen tonë drejtuar Atit në mënyrë që, në emër të Jezusit, të vazhdojë ta derdhë Shpirtin e Vet mbi ty dhe të kryejë çdo ditë të jetës tënde atë përngjasim me Krishtin që e ke aq të nevojshëm për të jetuar në plotësi “misterin e vënë në duart e tua” (Riti i Shugurimit).

A. L.

KREZMIME KREZMIME KREZMIME

Gjatë vitit 2014 Imzot Angelo Massafra ka kremtuar Sakramentin e Krezmimit në këto famulli të Arqipeshkvisë Shkodër-Pult:

- 1- Prill: Hot e Trush
- 2- Maj: kisha e Shën Françeskut në Gjuhadol, Koplik, kisha e Shën Kollit (Shkodër), Dobraç, Rrenc, Gur i Zi, Berdicë dhe Boriç
- 3- Qershor: Dajç Bregu i Bunës, Bajzë (kremtoi Imzot Cristoforo Palmieri), Gomsiqe (Velipojë), Velipojë-Qendër, Kukël, Arrë e Madhe (Shkodër-turni i parë), Katedrale, Qendra “Bariu i Mirë” (Fermentim-Shkodër), Arrë e Madhe (Shkodër-turni i dytë), Barbullush, Sheldi,

- Rragam, Selcë (kremtoi Imzot Zef Gashi)
- 4- Gusht: Juban, Rranxa Bushat, Stajkë, Vermosh (kremtoi Imzot Ramiro Moliner Inglés, Nunci apostolik)
- 5- Shtator: Vinotekë (Grudë e Re)
- 6- Tetor: Bardhaj (kremtoi Dom Nikolin Toma, Vikar Gjeneral), Kisha Don Bosko (Shkodër) (kremtoi Atë Gazmend Tinaj O.F.M., Ministër Provincial), Hot i Ri;
- 7- Dhjetor: Shkrel.

AKTIVITETE TË BARITORES RINORE



Në Asamblenë VIII të dioqezës Shkodër-Pult, Imzot Angelo Massafra nxiti bashkëpunëtorët me këtë thirrje: “le të dalim, le të shkojmë, le të humbasim kohë me të rinjtë e për të rinjtë”. Kjo nxitje na ka ndihmuar që të ndërmarrim disa nisma dioqezane për të mirën e të rinjve dhe për t’iu përgjigjur sado pak kërkesave të tyre.

Një takim shumë i rëndësishëm dhe me një pjesëmarrje të mirë nga të rinjtë universitarë është Takimi Biblik i udhëhequr nga dom Simo Lulij. Takimi është një herë në muaj dhe ka filluar në vitin 2013. Në shtator të vitit 2015 të rinjtë që kanë ndjekur takimet do të kenë mundësinë e një jave biblike apo ushtrime shpirtërore. Një tjetër grup universitarësh të Shkodrës takohet një herë në javë për të bërë një ecje në fe, duke u bazuar në Doktrinën Shoqërore të Kishës.

Personat që punojnë në fushën e formimit e dinë mjaft mirë se në formimin e të rinjve duhet shumë kohë, por nuk humbet kurrë kohë, sepse është një përgatitje që vlen për gjithë jetën.

Objektivi kryesor i Komisionit Baritor Rinor është formimi i të rinjve. Këto dy vitet e fundit kemi ndërmarrë nismën e formimit të animatorëve, qëllimi i të cilëve është që të jenë ndihmë e vleshme dhe kompetente në famulli, në qendrat baritore dhe në grupet ku ata jetojnë dhe shërbejnë.

Fusha e edukimit është shumë e gjerë, por jemi të bindur se edhe edukimi nëpërmjet sportit është një tjetër fushë me rëndësi të madhe. Në vitin 2014-2015 kemi ndërmarrë nismën e formimit të trajnierave në

bashkëpunim me Qendrën Sportive Shqiptare dhe me Qendrën Sportive Italiane CIS. Formimi i trajnierëve bëhet nga sportistët Antonio Marku dhe Ana Gjellaj çdo muaj dhe me një fund-javë nga specialistë CIS, që vijnë nga Milano. Të rinjtë që po formohen përcjellin njohuritë e tyre tek fëmijët e oratoreve të ndryshëm duke e kurorëzuar me kampionatin e futbollit, të volejbollit dhe të basketbollit.

Objektiv tjetër shumë i rëndësishëm është që të rinjtë e dioqezës sonë të kenë mundësi takimi, formimi, dhe shkëmbim përvojash mes tyre nëpërmjet takimeve të ndryshme. Për këtë arsye kemi ndërmarrë edhe një itinerar formimi për adoleshentët, që bëhet një herë në muaj në Fshatin e Paqes. Mesazhi i Papa Françeskut dhe vizita e tij historike në vendin tonë janë nxitje për një ecje në fe, për të gjitha moshat, në mënyrë të veçantë për adoleshentët.

Këto nisma, dhe të tjera që dëshirojmë të ndërmarrim, janë sugjeruar nga të rinjtë me të cilët punojmë, të cilët janë vetëm një pjesë e vogël e gjitha asaj rinie që dioqeza jonë ka.

Duke qenë se besojmë se e ardhmja e Kishës në Shqipëri janë të rinjtë, le t’i nxisim me shembullin tonë dhe le t’i mbështesim në formimin njerëzor dhe fetar.

Mt. Rita Ndoci



KRISHTLINDJE 2014 NË BREG LUMI - DUKAGJIN

Vijim i fq.8

i kërkon mikpritje”.

Të ngrohur prej zjarrit të oxhakut, prej rakisë së mirëseardhjes dhe sidomos prej dashurisë me të cilën na rrethonin duke u përkujdesur për ne, shijua gëzimin e pamasë të familjes Preka, sepse kishte në shtëpi jo një, por dy meshtarë, bekim i Hyjit dhe gjë e rrallë nga këto anë. Po të mos ishte për fra Antonion dhe shokët e tij të udhëtimit, këta vëllezër, këta vitet e fundit, ndoshta nuk do të kishin pasur as gëzimin që të kremtonin Meshën e shenjtë të Krishtlindjes.

Mungesa e rrymës elektrike në kishën e Breg Lumit, largësitë e banesave prej kishës dhe mungesa e rrugëve, nuk na lejuan ta kremtonim vigjiljen e Krishtlindjes së bashku me të gjithë të krishterët e luginës së Shalës, por na lejoi ta shijonim gëzimin e pritjes me familjen e Lulashit. Me ta bëmë një liturgji të vogël në familje, në gjuhën italiane dhe shqipe, për të bashkëndarë pritjen tonë të përbashkët të Shëlbuesit.

Në banesat e Dukagjinit mungojnë të gjitha rehatitë me të cilat jemi mësuar, por ju garantoj se as në një hotel me 5 yje nuk do të gjendej një vëmendje e tillë ndaj mysafirëve, një ngrohtësi e tillë familjare. Në atë pak po në atë asgjë gjendet gjithçka që ka rëndësi me të vërtetë. Kështu është edhe me Zotin, vetëm nëse do të dimë të zhvishemi prej vetvetes, prej sigurive tona, prej luksit tonë, do të mund ta njohim atë në fëmijën që gjendet në një grazhd.

Më 25, dita e Krishtlindjes, para se të shkonim në kishë për të

kremtuar Meshën e shenjtë, morëm pjesë në ritin e Lamit (Nata e Buzmit), një lutje e vjetër drejtuar Zotit, me të cilën kërkohet bekimi i arave prej të cilave e siguron jetesën familja. Mbi një kryq të bërë me kallama misri të shtrirë përtokë, vendosën frytet e dhuratave të Zotit dhe të punës së njeriut: bukë misri, djathë, ëmbëlsira të Krishtlindjes. Përreth e tyre e gjithë familja, e zgjeruar me praninë tonë, falënderon Hyjin dhe kërkon ndihmën e tij.

Kisha e ftohtë e Breg Lumit ngrohet shpejt nga qindra persona që kanë ardhur nga shtatë fshatrat përreth. Jashtë një diell i shkëlqyeshëm dhe tufat e zogjve përshëndesin Lindjen e Zotit të kremtuar në Dukagjin.

Pas Meshës së shenjtë, jashtë kishës, Cosmo bëhet Babagjyshi dhe mbi një gomar, u shpërndan dhurata fëmijëve të pranishëm. Një qese me karamela, çokollata e ëmbëlsira, që shumë persona kanë dhuruar nga Italia, do të jenë shenja e dashurisë për këta vëllezër të vegjël.

Është e vështirë t’i përshkruash fytyrat e fëmijëve që presin t’i thërrasin, ose gëzimi i papërmbajtshëm i tyre pasi kanë marrë këto dhurata të thjeshta. Ne jemi mësuar me fëmijët tanë të cilët nëse i pyesim: “çfarë të ka sjellë Babagjyshi?” të përgjigjen me një listë të harxheve.

Edhe një herë në thjeshtësinë dhe njëmendësinë e këtyre fytyrave, në dashurinë e vullnetarëve, në angazhimin e misionarëve për këta vëllezër mund të shihet Dashuria e Hyjit për njeriun, mund të shijohet Gëzimi i Krishtlindjes dhe i ardhjes së Zotit.

Vijon në fq.12

LAJME NGA DIOQEZA E SAPËS

INAUGURIMI I MUZEUT DIOQEZAN TË SAPËS

Dioqeza e Sapës, me rastin e festës së Krishtlindjes dhe fund vitit 2014 organizoi lobingun me Miqtë e Zadrimës, tashmë të pagëzuar me emrin “Miqtë e Sapës”. Kjo nismë e filluar që para 10 viteve (viti 2004) nga ish-ipeshkvi i asaj kohe, Imzot Dodë Gjergji, vit pas viti është trashëguar nga ipeshkvi pasardhës, Imzot Lucjan Avgustini, duke e çuar përpara këtë projekt në edukimin dhe zhvillimin e mbarë dioqezës, posaçe në fushën e vreshtarisë, ullishtes dhe blegtorisë. Në këtë takim të udhëhequr nga ipeshkvi i vendit ishin të pranishëm edhe ipeshkvi i Malit të Zi Imzot Zef Gashi, meshtarë e motra, ish-deputetë të zonës, Kryetarët e Bashkive Vau-Dejës dhe të Bushatit, ekspertë të fushave të ndryshme të ekonomisë, bujqësisë e turizmit, si edhe të ftuar të tjerë. Ky takim ishte i një rëndësie të veçantë, sepse, përveç bilancit të punës së këtij viti dhe përpjekjeve të përbashkëta në mbështetje të zhvillimit të komunitetit, u inaugurua edhe Muzeu Dioqezan i Sapës, i pari i këtij lloji në Shqipëri, të paktën në rangun kishtar.



Në fjalën e rastit Imzot Lucjani e cilësoi këtë muze si një muze simbolik dhe të vogël, por që flet shumë dhe mbart vlera të mëdha historike. Jam gjithmonë i mendimit tha ai, se gjërat e bukura dhe me vlerë duhet të vihen në pah për të mirën e të gjithëve dhe jo të mbahen të mbyllura në sirtar. Shpresoj që kjo nismë, e cila është e para në Dioqezën tonë, të shumohet edhe në dioqezat e tjera dhe në zemrat e njerëzve, e të dimë të bashkëpunojmë me njëri-tjetrin për dëshminë e kulturës, duke lënë gjurmë dhe duke shkruar faqet e historisë sonë përmes objekteve apo gjërave që kanë të bëjnë me traditën, kulturën e popullit dhe të vendit tonë, përfundoi ipeshkvi. Ndërsa Imzot Zef Gashi e vlerësoi këtë muze, që po shkruan një faqe të re në historinë e kësaj dioqeze.

Gjatë këtij takimi u mbajtën edhe disa referenca, si: “Historiku i

Dioqezës së Sapës”, referuar nga znj. Violeta Marashi; “Përmbledhje e veprimtarive të Kishës në favor të zhvillimit të komunitetit” me referon Z. Nikolin Lekaj; “Rikonceptimi i Lëvizjes Lobuese për zhvillimin e kësaj dioqeze”, referuar nga Z. Tom Preku, si edhe diskutime dhe përshëndetje nga pjesëmarrësit.

Muzeu dioqezan është me vlera të veçanta, pasi përmban sende dhe objekte kishtarë dhe arkeologjike të gjetura, të mbledhura dhe të ruajtura ndër vite.

Ndër më të veçantat janë:

- veshje të vjetra liturgjike të punuara me dorë;
- regjistra pagëzimi që në vitet 1800;

- rroba, enë liturgjike dhe libri i Meshës me të cilët ka kremtuar meshën Dom Prenk Qafalia në Gjegjan të Pukës;

- libri i meshës dhe enët liturgjike me të cilët ka kremtuar Meshën Dom Ejll Kovaçi;

- kryq dhe piksidë e përdorur prej Dom Jak Zekës;

- gurë elteri me relike brenda saj e kishës së vjetër të Gjegjanit;

- kumbona e kishës së Zojës në Dejë, e cila pati fatin e keq të rrënohej me dinamit;

- pjesë të thyera të këmbanës së kishës së Shën Lukës të Gomsiqes;

- kumbona e vjetër e vitit 1791;

- kelk i cili është përdorë për kremtimin e Meshës në burg;

- gurë të gdhendur të katedrales së vjetër të Sapës në Nënshat.

Një vend i veçantë u është rezervuar edhe martirëve të Kishës Katolike në Shqipëri, shoqëruar me hartën e burgjeve dhe të kampeve famëkeqe gjatë diktaturës komuniste. Në këtë muze nuk mund të mungonte edhe këndi kushtuar vizitës së Atit të shenjtë Papa Françeskut në Tiranë dhe dëshmisë së të mbijetuarës nga komunizmi, Motrës Marie Kaleta, stigmatine .

MINISTRJA KODHELI I DORËZON DOKUMENTIN HIPOTEKOR MOTRAT E NËNË TEREZËS NË PUKË

Merr fund çështja e pronësisë së shtëpisë së Motrave të Nënë Terezës në Pukë. Prej vitesh motrat e kësaj bashkësie u ishin drejtuar institucioneve dhe organeve përkatëse me kërkesat e herëpas hershme për kalimin në pronësi të objektit dhe të sheshit të ish-Spitalit Ushtarak dhe të Shkollë të lirë ushtarake, në qytetin e Pukës, që me ardhjen e motrave iu ishte dhënë për vendbanim, por asnjëherë nuk morën përgjigjen e duhur. Ndërsa kërkesa e fundit shkruar në shtator të vitit 2014, drejtuar Kryeministrit Rama dhe ministres së Mbrojtjes Kodheli, ka qenë fatsjellëse, ku falë miratimit nga kjo qeveri, pas 22 viteve u bë i mundur Akt-Dhurimi i kësaj prone dhe objekteve që ndodhen në të.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, me datën 13 janar, udhëtoi drejt Pukës vetë ministrja Kodheli. Në praninë e motrave të Nënë Terezës, Ipeshkvit të Sapës, Imzot Lucjan Avgustini dhe famullitarit Dom Giovanni Fiocchi, ajo dorëzoi Akt-dhurimin e objektit në fjalë Motrave Misionare të Bamirësisë të Nënë Terezës. Përmes fjalëve të rastit, znj. Kodheli shprehi mirënjohjen e saj për praninë e Motrave në mes këtyre maleve, që me misionin e tyre të dashurisë dhe të bamirësisë arrijnë të ngrohin zemrat e njerëzve të kësaj zone, duke ushtruar aktivitetin e tyre shpirtëror dhe human. “Meriton shumë më tepër edhe Kisha që shërben në këtë vend të ashpër nga natyra, por jo nga bujaria dhe devotshmëria. Unë kam pasur nderin e jashtëzakonshëm dhe fatin e madh ta takoj Nënë Terezën të paktën dy herë në jetën time . Është detyrimi im si ministre e qeverisë që unë përfaqësoj, ka vijuar më tej ministrja Kodheli, që të mundësoja sado pak për një dokument, i cili

duhet të ishte marrë dekada më parë”.

Edhe Imzot Avgustini falënderoi Ministren e Mbrojtjes për angazhimin e saj të drejtpërdrejtë, për nxjerrjen e kësaj kërkesë nga sirtarët e kësaj ministrie dhe në përcjellien Këshillit të Ministrave për miratim. “Ky vendim i qeverisë u dha fund shqetësimeve të mëdha, që shpeshherë kanë ndikuar edhe në mbarëvajtjen e misionit. Shprehim mirënjohjen tonë për gjithë mbështetjen që na dhatë në këtë drejtim dhe lutemi për ju” thanë motrat.

Më pas, ministrja Kodheli i dorëzoi përfaqësues së misionit “Nënë Tereza” në Pukë, dokumentin hipotekor me nr. 13, datë 09.12.2014, nëpërmjet të cilit objekti tashmë figuron në pronësi të këtij misioni bamirës. Pas këtij akti, ministrja e Mbrojtjes Kodheli dhe Imzot Avgustini zbuluan pllakën e vendosur në hyrje të këtij institucioni fetar me këtë mbishkrim: “Dhuratë e Ministres së Mbrojtjes për Motrat e Nënë Terezës me falënderimet për veprën e tyre të jashtëzakonshme. Zoti ju bekoftë! Mimi Kodheli”.

Misioni i motrave të Nënë Terezës në qytetin e Pukës ka filluar me datën 16 korrik 1992. Një muaj më vonë, më 15 gusht, ka qenë e pranishme edhe vetë e Lumja Nënë Tereza, e cila e vendosi përfundimisht misionin e motrave të saj në këtë qytet. Që nga ajo kohë, motrat ushtrojnë rregullisht misionin e tyre duke iu përmbajtur rregullave të kongregatës në ndihmë të më të varfërve të zonës së Pukës.

Violeta Marashi

KRISHTLINDJE 2014 NË BREG LUMI - DUKAGJIN

Vijim i fq.10



Faleminderit Zotit për këtë dhuratë të pamasë, për shokët shembullorë të udhëtimit; faleminderit për familjet shqiptare që na kanë mirëpritur si bekim të Hyjit; faleminderit për ngrohtësinë me të cilën misionarët italianë dhe fetërit shqiptarë na kanë rrethuar në kuvendin e Nënshatit dhe me të cilët



kemi bashkëndarë dy ditë para kthimit tonë.

Faleminderit Zotit që e ka ruajtur fenë në këtë popull të Shqipërisë, fe për të cilën janë përndjekur. Mbroji dhe ndihmoji ata në ecjen e tyre që të mund të kenë të ardhmen dhe dinjitetin e bijve të tu.

Rino Andriano

KRISHTLINDJE NË TOPLANË E DUSHMAN

Vijim i fq.5

dëshirash për emancipim, pasigurish mbi planet e ardhshme të kësaj toke dhe të krejt Tokës.

Çdo mbrëmje, pas mbrëmësore dhe darkës, para se të shkoj të fle, hedh një sy nga qielli; këtu mund të shikohet gjithçka me më pak ndotje, në krahasim me Italinë: ndriçimi publik nuk është i fortë, nganjëherë mungon krejt, dhe zhurmat janë ato të natyrës së kësaj stine. Është një qiell shumë i bukur, që afron shumë, kthjellon, përqafton dhe pranon. Krishtlindja jonë në Melgushë, në Koman, në Toplan (në Toplan më 29 e kremtoi Meshën Atë Agostini, meshtar vinçencian, ndërsa në Dushman me 3 janar Dom Charbeli Bachour) ka



Dushman

q e n ë : n j ë përqaftim i madh, i ngrohtë e mikpritës, në të cilin ishte bukur ta lëshonim veten, të dhuronim e të merrnim me një dhurim falas që ndihet fort, sepse është i njëmend të, i thjeshtë dhe i natyreshëm. Kalojnë shpejt ditët në këtë oaz bukurie në të cilin herë pas here bekimi i mungesës së rrymës elektrike i ngadalëson ritmet e jetës së përditshme dhe i



Toplanë

barazon me ato të shpirtit. Nisemi për t'u kthyer, kthehemi në Itali ku gjithçka është më e shpejtë, më e pasur, por edhe më e rrëshqitshme. Nisemi me trup, por e dimë se po lëmë këtu diçka prej nesh, si një fjalim i pambaruar, si një libër i hapur, si një rrugë vetëm e filluar. Do të kthehemi në këtë përqaftim. Është pak, por faleminderit Hyjit, është një siguri e bukur.

Riccardo



Drejtues
Imzot Angelo Massafra

Redaksia
Arqipeshkvia

Lektore
Loreta Tomaj

Faqosja
Luigj Mila

Shtypshkronja
"Gjergj Fishta"
Lezhë